




**KOMITETI KOMBËTAR
I DIGAVE TË MËDHA**



UNIVERSITETI "EPOKA"

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA
dhe
UNIVERSITETI "EPOKA"

[Handwritten signature]

Neni 1

Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë:

1. **Universiteti "EPOKA"**, licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave No. 281, datë 12/03/2008, me seli në rrugën Tiranë-Rinas, km 12, Vorë/Tiranë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Ahmet Öztaş, Rektor

Dhe

2. **Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM)**, me qendër në Tiranë, rruga *Abdi Toptani*, nr. 1, i përfaqësuar nga ing. Arjan Jovani, Kryetar.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit akademik dhe profesional nëpërmjet mbështetjes së veprimtarive arsimore, kërkimore dhe profesionale ndërmjet stafit akademik dhe studentëve të dy institucioneve. Në këtë kuadër dhe me miratimin e të dy palëve, bashkëpunimi do të përfshijë çdo fushë, e cila nga të dy palët gjykohet si e dëshirueshme, e mundshme dhe që i kontribuon zhvillimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy Palëve.

Neni 3

Parime bazë

Parime themelore rregulluese për bashkëpunimin e Palëve janë *autonomia institucionale, interesi dhe respekti i ndërsjelltë*.

Neni 4

Drejtimit kryesore të bashkëpunimit

Drejtimit kryesore të bashkëpunimit të Palëve janë përfshijë:

1. Zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta me interes të ndërsjelltë në studimet e ndërtimit, projektimit, administrimit, monitorimit dhe sigurisë së digave;
2. Organizimi i veprimtarive të përbashkëta kërkimore-shkencore si: konferenca, forume, konsultime etj.,

3. Pjesëmarrjen në seminare dhe takime akademike, kërkimore-shkencore dhe profesionale;
4. Shkëmbimin e materialeve akademike, kërkimore-shkencore dhe profesionale, si dhe të informacioneve të tjera; Shkëmbim të hulumtimeve studimore dhe shkencore, të dokumentacionit teknik informues dhe shkencor, standarteve teknike dhe udhëzuesve teknike.
5. Shkëmbimi njohurive teknike dhe ekipeve të specializuara dhe të kualifikuara në fushën përkatëse përmes një bashkëpunimi me interes reciprok.
6. Informimi reciprok mbi të rejat dhe zhvillimet e fushës në çdo institucion dhe më gjërë që paraqesin interes për aktivitetin institucional të Palëve.
7. Nga të dy palët, mund të iniciohen dhe zhvillohen projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, duke përdorur burimet e brendshme të të dy palëve, pa përjashtuar dhe mundësinë e financimit nga burime të treta;
8. Shkëmbime të stafëve dhe ekspertëve me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtejshme të stafit nga të dy Palët ;
9. Ofrimi i ekspertizës nga ana e stafit akademik në çështjet dhe problematika teknike;
10. Vendosjen e një bashkëpunimi afatgjatë e të institucionalizuar midis Inxhinierëve të Rinj të diplomuar në Universitetin "EPOKA" dhe Forumit të Inxhinierëve të Rinj të Digave, që funksionon pranë KKDM; duke përfshirë të drejtën e propozimit për anëtarësime të ndërsjellta mbi bazën e meritës dhe perspektivës;
11. Krijimin e skuadrave dhe sinergjive intelektuale për të ndikuar në mirëqeverisje për çështje me karakter strategjik, si: aktivizimi i burimeve natyrore, mbrojtja e ekosistemeve; ndryshimet në hidrologjinë e rajoneve ku janë ndërtuar diga;
12. Mundësimin e kryerjes së temës së diplomës për studentët e regjistruar në programin e studimit "Master i Shkencave" të ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, duke konsideruar mundësimin e përfshirjes së këtyre studentëve në projekte të ndryshme të KKDM.
13. Mundësimin e përfshirjes për studentët e regjistruar në programin e Doktoratës të ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në projekte të ndryshme të KKDM si dhe në tematika dhe çështje të evidentuara nga puna e KKDM.

Detajet e kësaj asistence të ndërsjellë dhe buxheti i nevojshëm për çdo veprimtari specifike që do të zbatohet në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të diskutohet dhe do të miratohet me shkrim nga të dy palët para fillimit të një programi ose veprimtarie të veçantë. Detajet e këtyre programeve ose veprimtarive do të negociohen çdo vit.

Seicili nga institucionet do të përcaktojë një person bashkërendues, i cili do të sigurojë zhvillimin si dhe bashkërendimin e programeve dhe veprimtarive specifike.




Neni 5

Detyrime e palëve

1. Universiteti "EPOKA" mirëpret pjesëmarrjen e anëtarëve të propozuar nga KKDM në komisionet e posaçme të ngritur pranë tij si edhe fton KKDM të marrë pjesë me përfaqësues të saj në organizma vendimmarrës, si këshilli i botimeve, konkurset për çmimet e mëdha vjetore kombëtare e ndërkombëtare, në formën e ekspertizës dhe pjesëmarrjes në juri.
2. Me kërkesë të KKDM Universiteti "EPOKA" jep kontribut, sipas mundësive të tij, edhe për një bashkëpunim të frytshëm me Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD).
3. KKDM mirëpret bashkëpunimin me grupet e ekspertëve dhe konsulentëve që janë pranë Universitetit "EPOKA" në fushën e inxhinierisë, të ndërtimit, monitorimit dhe sigurisë dhe me kërkesën e tyre merr pjesë në veprimtaritë përkatëse.

Neni 6

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor që ruhet në arkivat e tyre; të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. KKDM i dhuron pa shpërblim koleksione të botimeve të saj bibliotekës së Universitetit "EPOKA".

Palët inkurajojnë krijimin e bibliotekave dhe arkivave të numerizuar.

Neni 7

Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve*, kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme.

Neni 8

Njoftimet dhe komunikimi ndërmjet palëve

Palët angazhohen të mbajnë linja të hapura komunikimi në të gjitha nivelet dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për punën e tyre. Cdo njoftim dhe komunikim mes *Palëve* për këtë Marrëveshje duhet të jetë në formë të shkruar.

Komunikimet për efekt të kësaj marrëveshje do të kryhen drejpërdrejt me Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit "EPOKA" dhe me Sekretariatën Kombëtare pranë KKDM.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Marrëveshja ka një afat tre (3) vjeçar duke nisur nga data e nënshkrimit.

Kohëzgjatja mund të ndryshohet ose të rinovohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet dy *Palëve*.

Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën *Palë*, me vlerë të barabartë.

Për:

**Komitetin Kombëtar
të Digave të Mëdha (KKDM)**

Kryetari

Ing. Arjan JOVANI,

Universitetin "EPOKA"

Rektori

Prof. Dr. Ahmet ÖZTAŞ,

Tiranë, 06.12.2024



Komunikimet për efekt të kësaj marrëveshje do të kryhen drejpërdrejt me Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit "EPOKA" dhe me Sekretariatën Kombëtare pranë KKDM.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Marrëveshja ka një afat tre (3) vjeçar duke nisur nga data e nënshkrimit.


Kohëzgjatja mund të ndryshohet ose të rinovohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet dy *Palëve*.

Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën *Palë*, me vlerë të barabartë.

Për:


**Komitetin Kombëtar
të Digave të Mëdha (KKDM)**

Kryetari


Ing. Arjan JOVANI,

Universitetin "EPOKA"

Rektori


Prof. Dr. Ahmet ÖZTAŞ,



Tiranë, 06.12.2024